



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivery	03.08	2022	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednina Org./Unit	Nr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/JHCY	4513/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.551/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.551/2022 të datës 21.06.2022 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë: kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.551/2022 e datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesi e precizuar sipas parashtrësës së datës 25.07.2022.
- II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që ankuesit t'ia bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive për periudhën kohore nga data 13.05.2022 deri me datë 18.07.2022 në ekuivalencë me pagën për kategori të mesme drejtuese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës ka qenë i punësuar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike sipas vendimit për transferim të datës



21.01.2021 me numër:09/59, ndërsa përmes kërkesës së 13.06.2022 i është drejtuar ZV/Drejtoreshës së Departamenti për Menaxhimi e Zyrtarëve Publik duke e njoftuar se të njëjtit i ka përfunduar mandati me datë 11.02.2022 dhe ende nuk është emëruar sipas dispozitave të ligjit material.

Ankuesi, kundër heshtjes administrative me datë 21.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimet ankimore se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që të njëjtit kanë qenë të obliguar sipas detyrës zyrtare ta emërojnë ankuesin në një pozitë të mesme drejtues dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale, me kërkesën që ankuesi të emërohet në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe të njëjtit t'ia kompensojnë pagën nga pozita e nivelit të mesëm drejtues për periudhën kohore nga data 13.05.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa Këshilli me datë 13.07.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik /MPB me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 21.06.2022 me numër protokollit 3592/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Autorizimin e datës 13.06.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 07.02.2014; Vendimin me numër:06/73 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 05.02.2016; Vendimin me numër:03/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.02.2019; Vendimin për transferimin e ankuesit i datës 21.01.2021 me numër:09/59 i nxjerr nga Qeverisë së Republikës së Kosovës; Njoftimin e datës 13.01.2022 dërguar nga Menaxheri i Personelit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Kërkesën e ankuesit të datës 13.06.2022 dërguar nga ankuesi për Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.06.2022; Përgjigjen në kërkesën e protokolluar në Këshill me datë 13.07.2022; E-mailin e dërguar me datë 08.07.2022 nga arkiva e MPB-së për Këshillin me provat e lëndës; Shkresën e datës 08.07.2022 me numër prot:1093; E-mailin e datës 13.01.2022 dërguar nga XH.K për SH.L; E-mailin e datës 13.01.2022 dërguar nga Sh.L për A.K; Parashtresën për precizimin e objektit të ankesës së ankuesit e datës 25.07.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 18.07.2022 me numër:AE.Nr.10/2022; Vendimin për emërimit e ankuesit i datës 13.07.2022 nxjerr nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; E-mailin e datës 20.07.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej tri (3) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është *e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Vendimit me numër:03/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.02.2019 ka qenë i emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa përmes Vendimit të datës 21.01.2021 me numër:09/59 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është transferuar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa mandati i tij në këtë pozitë zgjatë sipas përcaktimit të vendimit të datës 12.02.2019 me numër:03/89.

Ankuesi me datë 25.07.2022 e ka njoftuar Këshillin me parashtresë se i njëjti sipas Vendimit të datës 13.07.2022 të nxjerr nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është emëruar në pozitën e punës: *“Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale”* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e ministrisë respektive i ka lëshuar ankuesit Aktin e Emërimit të datës 18.07.2022 me numër AE.Nr.10/2022 duke i konfirmuar emërimin në detyrë me kohë të pacaktuar dhe mbi këtë bazë meqenëse objekti i ankesës së ankuesit të datës 21.06.2022 është bërë pjesërisht i pamundur për shqyrtim për shkak të krijimit të rrethanave të reja, ankuesi me datë 25.07.2022 ka bërë precizimin e ankesës së datës 21.06.2022 me kërkesën që tani Këshilli të trajtojë vetëm kërkesën e ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të pagës ekuivalente me pagën e kategorisë së mesme drejtuese për periudhën kohore nga data 13.05.2022 deri me datë 18.07.2022, me pretendimin se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka qenë i obliguar ta emëroj ankuesin sipas detyrës zyrtare që nga data 13.05.2022 përderisa një veprim të tillë nuk e ka ndërmarrë deri me datë 13.07.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit sipas precizimit të objektit të ankesës sipas parashtresës së datës 25.07.2022 ka analizuar dispozitat e nenit 42 paragrafi 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik Ku përcaktohet se: *“Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t’u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil. 9. Gjatë periudhës 3 mujore në pritje të emërimit, nëpunësi mund të konkurrojë për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, përveç asaj për të cilën i ka mbaruar mandati”* dhe ka konstatuar se Njësia e Pranimit, në rastin konkret Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik është i obliguar sipas detyrës zyrtare të emëroj ankuesin brenda afatit kohore prej tre (3) muajsh prej momentit kur të njëjtit i përfundon mandati i emërimit në pozitë të kategorisë së Lartë Drejtuese në Shërbimin Civil, madje vonesat e tilla për emërim e të cilat nuk varen nga kërkesat e palëve por obligimet rrjedhin sipas detyrës zyrtare dhe e bëjnë përgjegjëse Njësinë e Pranimit edhe për kompensimin e dëmit material në rastin e caktuar.

Kolegj për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pash shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe pasqyrimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se sipas Vendimit me numër:03/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.02.2019 ka qenë i emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa përmes Vendimit të datës 21.01.2021 me numër:09/59 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është transferuar në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa mandati i tij në këtë pozitë zgjatë sipas përcaktimit të vendimit të datës 12.02.2019 me numër:03/89, respektivisht ankuesit mandati i ka përfunduar me datë 12.02.2022 ndërsa afati i fundit për emërimi në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese ose kategorisë profesionale ka qenë data 12.05.2022 ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik një obligim ligjor dhe sipas autorizimit ligjor nuk e ka përmbush deri me datë 13.07.2022 respektivisht ankuesi është konfirmuar në detyrë me datë 18.07.2022 bazuar në Aktin e Emërimit me numër: AE.Nr.10/2022 në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, andaj mbi këtë bazë periudha kohore gjatë se cilës ankuesi ka mbetur i paemëruar prej datës 13.05.2022 deri me datë 18.07.2022 dhe se i njëjti është

dëmtuar materialisht dhe profesionalisht bie mbi barrën e përgjegjësive të Ministrisë të Punëve të Brendshme pasi që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik funksionon në kuadër të saj, andaj Ministria e Punëve të Brendshme obligohet që ankuesit t'ia bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagës ekuivalente me pagën për kategorinë e mesme drejtuese për periudhën kohore nga 13.05.2022 deri me datë 18.07.2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se vonesat për emërim nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe zgjatja e afateve të tyre jashtë atyre që ka përcaktuar ligji material është veprim që bie ndesh me parimet e Shërbimit Civil të përcaktuara si në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paaanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë".

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.551/2022

**Flakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**



Kryetar i Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit-Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB
- Arkivit të KPMSHCK-së

